

Gjuha e urrejtjes është e panjohur për mua

Ofendimi dhe promovimi i urrejtjes, veçanërisht ndaj grupeve vulnerable shoqërore është në kundërshtim të plotë me parimet e angazhimit tim në sferën publike

DR. FERID AGANI

Kjo komunikatë është përgjigje në komunikatën për shtyp të organizatave joqeveritare Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut dhe Qendra për Emancipimin Shoqëror, të botuar në gazetën "Koha Ditore", më 02 tetor 2006. Çështja ka të bëjë lidhur me deklaratën time mbi homoseksualizmin, të dhënë gazetës "Iliria Post". Këto dy organizata e kanë keqkuptuar këtë deklaratë në mënyrën më serioze duke e cilësuar në mënyrë tendencioze personalitetin tim dhe çështjen në fjalë. Shfrytëzoj këtë rast për të qartësuar këtë çështje të cilën e konsideroj, veçanërisht të rëndësishme, në aspektin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Fillimisht dëshiroj që të ritheksoj dhe të sqaroj qëndrimet e mia lidhur me homoseksualizmin.

1. Si anëtar i komunitetit profesional dhe shkencor, të gjitha aktivitetet e mia kanë qenë dhe do të jenë të mbështetura mbi rregullat dhe parimet e tij themelore. Mbështetur në këtë fakt, edhe në deklaratën time fillimisht kam theksuar se

homoseksualizmi, aktualisht nuk konsiderohet si sëmundje ose çrregullim psikik nga ana e organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare në lëmin e psikiatrisë ose psikologjisë.

2. Njëkohësisht, gjatë punës sime shumëveçare klinike, në shumë raste kam trajtuar persona homoseksualë të cilët lëngonin nga çrregullime psikiatrike, që në një mënyrë ishin të lidhura me identitetin e tyre seksual. Këto përvoja klinike, krahas vlerësimeve të qarta për këtë çështje në librat e shenjtë dhe kundërthënia e tyre me pozicionin e sipërpërmendur, zyrtar, të institucioneve relevante ndërkombëtare, më kanë shtyrë në konkludimin se shkencën ende nuk i ka dhënë përgjigjet përfundimtare lidhur me këtë çështje. Deklarata ime, në mënyrë parësore reflekton perspektivën personale, të kushtëzuar me aspektin kulturor të kësaj çështje si dhe përvojën time klinike, të lidhur me të.

3. Individët me orientim homoseksual janë subjekt i diskriminimit në shumë shoqëri; në disa raste, kjo fatkeqësisht ka ndodhur edhe në shoqërinë koso-

vare. Të qenit subjekt i çfarëdo lloji të diskriminimit, mund të shkaktojë çrregullime serioze të shëndetit mendor. Shoqëria dhe institucionet e Kosovës duhet të luftojnë pa asnjë hezitim diskriminimin e çfarëdo lloji dhe të promovojnë aktivitete në këtë drejtim duke siguruar përkrahje të plotë për qytetarët, të cilët kanë nevojë për këtë.

Jam koshient që këto fakte nuk kanë qenë në mënyrë të mjaftueshme të elaboruara në deklaratën time. Ofendimi dhe promovimi i urrejtjes, veçanërisht ndaj grupeve vulnerable shoqërore është në kundërshtim të plotë me parimet e angazhimit tim në sferën publike. Gjuha e urrejtjes është e panjohur për mua. Besoj se të dhënat lidhur me punën time në lëmin e të drejtave të njeriut flasin për vete. Është e qartë se ekziston nevoja që t'i qasemi kësaj çështje me shkallë të shtuar të ndjeshmërisë, në kuadër të forumeve ose debateve të përgatitura mirë, profesionale dhe edukative. E shpreh gatishmërinë time të plotë për të kontribuar në këtë drejtim.